



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 579/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbër nga, Nehat Idrizi kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), paraqitur kundër Isa Berisha koordinator i vëzhguesve të AAK-së në QV 2006/a në Tusus të Prizrenit, për shkak të kërcënimit gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN).

- I. **Aleanca për Ardhmerinë e Kosovës (AAK)**, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 4000 (katërmijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në buxhetin e Republikës së Kosovës.
- II. **Isa Berisha**, i lindur me 19.11.1972 me nr. identifikimi 1006528429, në cilësinë e kordinatorit të vëzhguesve të AAK-së në vendvotimin 2006/a në lagjen Tusus të Prizrenit, i ndalohet për 4 (katër) vite, të marrë pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së si kandidat dhe 6 (gjashtë) vite, si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, duke filluar nga plotfuqishmëria e këtij vendimi.

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), në të cilën pretendohet se me datë 12.12.2010, në QV Nr. 2006/a në lagjen Tusus të Prizrenit, koordinatori i vëzhguesve të AAK-së, Isa Berisha ka mbajtur armën e tij të tipit "TT" kalibri 8.9 mm, prej hapjes së vendvotimit e deri kur është arrestuar nga njësitet e policisë dhe është dërguar në stacionin e policisë, ku me atë rast i është konfiskuar arma, mirëpo i njëjti me urdhër të prokurorit është liruar. Sipas parashtruesit të ankesës kjo përbën shkelje të nenit 33 pika c) të LPZ-se".

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë, përveç se ka siguruar numër kontakt te Petrit Kryeziu, Qazim Hasanaj, Hazir Berisha, dhe Sabir Hasani ne cilësinë e dëshmitarëve.

Ne raportin e policisë dt. 12.12.2010 me Nr. reference 2010-GA-3726, te lëshuar nga rreshteri policor Asim Muja #3204, lënda ku njofton se: Me datën 12.12.2010 rreth orës 15:45 është marr informacioni se ne vendvotimin në shkollën fillore “Fadil Hisari” kordinator i PBD-së është i armatosur. NJSO ka dal në vendin e ngjarjes dhe ka kontaktuar me të dyshuarin Isa Berisha, i lindur me 19.11.1972 në fshatin Lez dhe me banim në Prizren, rruga Zahir Pajaziti ku ka pranuar se posedon një armë M57 prodhim Jugosllav të kalibrut 7.62 për të cilën nuk posedon leje dhe 9 fishekë të të njejtit kaliber. Arma është konfiskuar dhe me zingjirin ruajtës është dërguar në Forensikë.

Në konsultim me prokurorin e Qarkut rasti shkon në procedurë të rregulltë.

Sanksionimi për shkeljet e parimeve të këtij Kodi

Neni 34.2 parasheh si viojn:

Asnjë subjekt politik ose kandidatet nuk inkurajojnë, mbështesin ose miratojnë dhunën, kërcenimet me dhunë ose kanosje, gjatë procesit zgjedhor.

Neni 8 paragrafi 1 i Rregullës Zgjedhore nr. 11/2009, parasheh;

Shkelja e njërit nga këto nene të kodit të Sjelljes, në rastet kur këto shkelje nuk kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve, konsiderohet shkelje administrative dhe e dënueshme me gjobë sikurse është përcaktuar nga PZAP-i.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

120.1 c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Neni 120 paragrafi 3 pika (d) i LZP-së, parasheh se:

120.3 d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite.

Duke vendosur për gjobën PZAP ka marrë si rrethanë rënduese se shkelja ka të bëjë me veprimet e ndaluara dhe thyerjen e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët. PZAP sa i përket ndalimit për pjesëmarrje si kordinator i vezhguesve siç është theksuar në dispozitiv të këtij vendimi ka marrë se shkelja ka ndodhur nga personi që ka qenë në dijeni me rregullat dhe procedurat e votimit. Prandaj nga arsyet lartcekura e më qëllim të evitimit të shkeljeve të potencuar më lartë dhe në pajtim më dispozitat e lartcekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 579/2010 më datën 16.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**

